



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 34

Tiranë – E enjte, 4 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 24.2.2021	Për miratimin e marrëveshjes, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë japoneze, mbi ndihmën grant të Japonisë “Programi i zhvillimit ekonomik dhe social” (sigurimi i pajisjeve mjekësore)..... 4415
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 117, datë 19.2.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 23, datë 18.1.2021, “Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të nivelit të parë epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara”..... 4425
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 136, datë 25.2.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 100, datë 10.2.2021 “Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, <i>fast food</i> -ve dhe lokaleve”..... 4425
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 137, datë 25.2.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021 “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”..... 4425
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 4.2.2021	Fatbardh Budo kundër Shqipërisë (<i>Kërkesa nr. 7576317</i>)..... 4426
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 26.2.2021	Me objekt: shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i togfjalëshit “nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit” të pikës 1 të nenit 453 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe togfjalëshit “... i së njëjtës gjykatë” të pikës 3 të nenit 453 të KPP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017..... 4427
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 26.2.2021	Me objekt: konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjyqimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor..... 4439



VENDIM
Nr. 108, datë 24.2.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË JAPONEZE, MBI NDIHMËN
GRANT TË JAPONISË “PROGRAMI I
ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE
SOCIAL” (SIGURIMI I PAJISJEVE
MJEKËSORE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë japoneze, mbi ndihmën grant të Japonisë “Programi i zhvillimit ekonomik dhe social” (Sigurimi i pajisjeve mjekësore), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tiranë, më 3 shkurt, 2021

Shkëlqesi,

Kam nderin t’u referohem diskutimeve të fundit të bëra midis përfaqësuesve të Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Përfituesi”) në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez, që do të shtrihet me qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë, dhe të propozoj në emër të Qeverisë së Japonisë marrëveshjen e mëposhtme:

1. Me qëllim që të kontribuojë në zbatimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Social (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Programi”) të

Përfituesit, Qeveria e Japonisë do t’i japë Përfituesit, duke iu nënshtruar ligjeve dhe rregulloreve përkatëse dhe ndarjeve buxhetore të Japonisë, një grant prej 100, 000, 000 jen japonezë (Y 100, 000, 000) (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Granti”).

2. (1) Granti dhe interesi i tij rrjedhës do të përdoren nga Përfituesi në mënyrën e duhur dhe ekskluzivisht për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve të nevojshme për zbatimin e Programit, të renditura në një listë për t’u dakorduar reciprokisht midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Produkte” dhe “Shërbime”), si dhe për pagimin e tarifave të tilla të nevojshme për zbatimin e Programit, me kusht që Produktet të prodhohen në vende me origjinë të pranueshme dhe shërbimet të sigurohen nga shtetas të vendeve me origjinë të pranueshme.

(2) Lista e përmendur në nënparagrafin (1) më lart do t’i nënshtrohet modifikimeve për të cilat mund të bihet dakord midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

(3) Lista e vendeve me origjinë të pranueshme të përmendur në nënparagrafin (1) më lart do të dakordohet mes autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

3. (1) Përfituesi do të hapë një llogari të zakonshme depozite në jen japonezë në një bankë në Japoni në emrin e Përfituesit (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Llogaria”) brenda katërmëdhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje dhe do të njoftojë me shkrim Qeverinë e Japonisë për përfundimin e procedurës për hapjen e llogarisë brenda shtatë ditëve nga data e hapjes së llogarisë.

(2) Qëllimi i vetëm i llogarisë është marrja e pagesës në jen japonezë nga Qeveria e Japonisë referuar në paragrafin 4, si dhe kryerja e pagesave të nevojshme për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve, dhe pagesa të tjera të tilla siç mund të bihet dakord midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

4. Qeveria e Japonisë do të ekzekutojë grantin, duke bërë pagesën në jen japonezë të shumës së përmendur në paragrafin 1 në llogari, gjatë periudhës midis datës së marrjes së njoftimit me shkrim të përmendur në nënparagrafin (1) të paragrafit 3 dhe datës 31 mars 2021. Periudha mund të zgjatet me pëlqimin e ndërsjellë midis



autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

5. (1) Përfituesi do të marrë masat e nevojshme:

a) të sigurojë që granti dhe interesi i tij rrjedhës janë disbursuar plotësisht nga llogaria për të qenë gati për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve dhe për pagimin e tarifave të përmendura në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh pas datës së ekzekutimit të Grantit, përveç nëse periudha zgjatet me pëlqimin e ndërsjellë të autoriteteve të interesuara të dy qeverive dhe t'i kthejë Qeverisë së Japonisë shumën e mbetur pas përfundimit të Programit;

b) të sigurojë që detyrimet doganore, taksat e brendshme dhe taksat e tjera fiskale që mund të vendosen në vendin e Përfituesit në lidhje me blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve janë mbartur nga autoriteti i tij i caktuar pa përdorur grantin dhe interesin e tij rrjedhës;

c) të sigurojë kujdesin e duhur mjedisor dhe social në përdorimin e grantit dhe interesit të tij rrjedhës;

d) t'i paraqesë qeverisë së Japonisë një raport të përgatitur në formë të shkruar të pranueshme për Qeverinë e Japonisë mbi transaksionet në llogari së bashku me kopjet e kontratave, faturave dhe dokumenteve të tjera në lidhje me transaksionet përkatëse pa vonesë kur granti dhe interesi i tij rrjedhës janë përdorur plotësisht për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve dhe për pagesën e tarifave të përmendura në nënparagrafin (1) të paragrafit 2, ose me kërkesë të Qeverisë së Japonisë;

e) të sigurojë që produktet dhe/ose shërbimet do të mirëmbahen dhe përdoren si duhet dhe në mënyrë të efektshme për zbatimin e Programit, dhe nuk do të përdoren për qëllime ushtarake;

f) të sigurojë që produktet dhe/ose shërbimet do të përdoren, në parim, nga përdoruesit fundorë duke përfshirë vetë Përfituesin, për qëllime jotregtare;

g) të sigurojë shkarkimin e shpejtë, zhdoganimin dhe transportin e brendshëm në vendin e Përfituesit të Produkteve;

h) të garantojë sigurinë e personave të përfshirë në zbatimin e Programit në vendin e Përfituesit;

i) t'u akordojë personave fizikë japonezë dhe/ose personave fizikë të vendeve të treta, shërbimet e të cilëve mund të kërkojnë në lidhje

me furnizimin e produkteve dhe/ose shërbimeve, lehtësira të tilla që mund të jenë të nevojshme për hyrjen e tyre në vendin e Përfituesit dhe qëndrimin atje për kryerjen e punës së tyre;

j) të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Programit, përveç atyre që mbulohen nga granti dhe interesi i tij rrjedhës të nevojshme për implementimin e programit; dhe

k) t'i sigurojë Qeverisë së Japonisë një raport përfundimtar për Programin pas përfundimit të tij.

(2) Sipas kërkesës, Përfituesi do t'i sigurojë Qeverisë së Japonisë informacionin e nevojshëm për Grantin dhe interesin e tij rrjedhës.

(3) Në lidhje me transportin dhe sigurimin detar të produkteve, Përfituesi do të përmbahet nga vendosja e kufizimeve që mund të pengojnë konkurrencën e ndershme dhe të lirë midis shoqërive të sigurimit dhe transportit detar.

(4) Produktet dhe/ose shërbimet nuk do të eksportohen ose riekportohen nga vendi i Përfituesit.

6. Detajet e mëtejshme procedurale për zbatimin e kësaj marrëveshje do të dakordohen me konsultime midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

7. Qeveria e Japonisë dhe Përfituesi do të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo çështje që mund të lindë nga ose në lidhje me këtë marrëveshje.

Më tej, unë kam nderin të propozoj që kjo notë verbale dhe nota verbale e Shkëlqesisë Suaj në përgjigjen që konfirmon në emër të Përfituesit, marrëveshjen e mësipërme do të përbëjë një marrëveshje midis Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Qeveria e Japonisë e njoftimit me shkrim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje.

Përfitoj nga rasti për t'i ripërsëritur Shkëlqesisë Suaj sigurinë e konsideratës sime më të lartë.

Takada Mitsuyuki

AMBASADOR I JASHTËM DHE

FUQIPLOTË I

JAPONISË NË REPUBLIKËN

E SHQIPËRISË



Tiranë, më 3 shkurt, 2021

Shkëlqesi,

Kam nderin të pranoj marrjen e notës verbale të shkëlqesisë tuaj të datës së sotme, e cila lexon si më poshtë:

“Kam nderin t’u referohem diskutimeve të fundit të bëra midis përfaqësuesve të Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Përfituesi”) në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez, që do të shtrihet me qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë, dhe të propozoj në emër të Qeverisë së Japonisë marrëveshjen e mëposhtme:

1. Me qëllim që të kontribuojë në zbatimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Social (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Programi”) të Përfituesit, Qeveria e Japonisë do t’i japë Përfituesit, duke iu nënshtruar ligjeve dhe rregulloreve përkatëse dhe ndarjeve buxhetore të Japonisë, një grant prej 100, 000, 000 jen japonezë (Y 100, 000, 000) (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Granti”).

2. (1) Granti dhe interesi i tij rrjedhës do të përdoren nga Përfituesi në mënyrën e duhur dhe ekskluzivisht për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve të nevojshme për zbatimin e Programit, të renditura në një listë për t’u dakorduar reciprokisht midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Produkte” dhe “Shërbime”), si dhe për pagimin e tarifave të tilla të nevojshme për zbatimin e Programit, me kusht që produktet të prodhohen në vende me origjinë të pranueshme dhe shërbimet të sigurohen nga shtetas të vendeve me origjinë të pranueshme.

(2) Lista e përmendur në nënparagrafin (1) më lart do t’i nënshtrohet modifikimeve për të cilat mund të bihet dakord midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

(3) Lista e vendeve me origjinë të pranueshme të përmendur në nënparagrafin (1) më lart do të dakordohet mes autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

3. (1) Përfituesi do të hapë një llogari të zakonshme depozite në jen japonez në një bankë

në Japoni në emrin e Përfituesit (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Llogaria”) brenda katërmëdhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje dhe do të njoftojë me shkrim Qeverinë e Japonisë për përfundimin e procedurës për hapjen e llogarisë brenda shtatë ditëve nga data e hapjes së llogarisë.

(2) Qëllimi i vetëm i llogarisë është marrja e pagesës në jen japonezë nga Qeveria e Japonisë referuar në paragrafin 4, si dhe kryerja e pagesave të nevojshme për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve, dhe pagesa të tjera të tilla siç mund të bihet dakord midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

4. Qeveria e Japonisë do të ekzekutojë grantin, duke bërë pagesën në jen japonezë të shumës së përmendur në paragrafin 1 në llogari, gjatë periudhës midis datës së marrjes së njoftimit me shkrim të përmendur në nënparagrafin (1) të paragrafit 3 dhe datës 31 mars 2021. Periudha mund të zgjatet me pëlqimin e ndërsjellë midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

5. (1) Përfituesi do të marrë masat e nevojshme:

a) të sigurojë që granti dhe interesi i tij rrjedhës janë disbursuar plotësisht nga llogaria për të qenë gati për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve dhe për pagimin e tarifave të përmendura në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 brenda një periudhe prej dymbëdhjetë muajsh pas datës së ekzekutimit të grantit, përveç nëse periudha zgjatet me pëlqimin e ndërsjellë të autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit dhe t’i kthejë Qeverisë së Japonisë shumën e mbetur pas përfundimit të Programit;

b) të sigurojë që detyrimet doganore, taksat e brendshme dhe taksat e tjera fiskale që mund të vendosen në vendin e Përfituesit në lidhje me blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve janë mbartur nga autoriteti i tij i caktuar pa përdorur grantin dhe interesin e tij rrjedhës;

c) të sigurojë kujdesin e duhur mjedisor dhe social në përdorimin e Grantit dhe interesit të tij rrjedhës;

d) t’i paraqesë qeverisë së Japonisë një raport të përgatitur në formë të shkruar të pranueshme për Qeverinë e Japonisë mbi transaksionet në



llogari së bashku me kopjet e kontratave, faturave dhe dokumenteve të tjera në lidhje me transaksionet përkatëse pa vonesë kur granti dhe interesi i tij rrjedhës janë përdorur plotësisht për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve dhe për pagesën e tarifave të përmendura në nënparagrafin (1) të paragrafit 2, ose me kërkesë të Qeverisë së Japonisë;

e) të sigurojë që produktet dhe/ose shërbimet do të mirëmbahen dhe përdoren si duhet dhe në mënyrë të efektshme për zbatimin e Programit, dhe nuk do të përdoren për qëllime ushtarake;

f) të sigurojë që produktet dhe/ose shërbimet do të përdoren, në parim, nga përdoruesit fundorë duke përfshirë vetë Përfituesin, për qëllime jotregtare;

g) të sigurojë shkarkimin e shpejtë, zhdoganimin dhe transportin e brendshëm në vendin e Përfituesit të produkteve;

h) të garantojë sigurinë e personave të përfshirë në zbatimin e Programit në vendin e Përfituesit;

i) t'u akordojë personave fizikë japonezë dhe/ose personave fizikë të vendeve të treta, shërbimet e të cilëve mund të kërkojnë në lidhje me furnizimin e produkteve dhe/ose shërbimeve, lehtësira të tilla që mund të jenë të nevojshme për hyrjen e tyre në vendin e Përfituesit dhe qëndrimin atje për kryerjen e punës së tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

j) të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Programit, përveç atyre që mbulohen nga granti dhe interesi i tij rrjedhës të nevojshme për implementimin e programit; dhe

k) t'i sigurojë Qeverisë së Japonisë një raport përfundimtar për Programin pas përfundimit të tij.

(2) Sipas kërkesës, Përfituesi do t'i sigurojë Qeverisë së Japonisë informacionin e nevojshëm për Grantin dhe interesin e tij rrjedhës.

(3) Në lidhje me transportin dhe sigurimin detar të produkteve, Përfituesi do të përmbahet nga vendosja e kufizimeve që mund të pengojnë konkurrencën e ndershme dhe të lirë midis shoqërive të sigurimit dhe transportit detar.

(4) Produktet dhe/ose shërbimet nuk do të eksportohen ose riekportohen nga vendi i Përfituesit.

6. Detajet e mëtejshme procedurale për zbatimin e kësaj marrëveshje do të dakordohen me konsultime midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

7. Qeveria e Japonisë dhe Përfituesi do të konsultohen me njëra-tjetrën në lidhje me çdo çështje që mund të lindë nga ose në lidhje me këtë marrëveshje.

Më tej, unë kam nderin të propozoj që kjo notë verbale dhe nota verbale e Shkëlqesisë Suaj në përgjigjen që konfirmon në emër të Përfituesit, marrëveshjen e mësipërme do të përbëjë një marrëveshje midis Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Qeveria e Japonisë e njoftimit me shkrim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje."

Më tej, unë kam nderin të konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë marrëveshjen e lartpërmendur dhe të konfirmoj që nota verbale e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo notë verbale do të përbëjë një marrëveshje midis Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Qeveria e Japonisë e njoftimit me shkrim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje."

Përfitoj nga rasti për t'i ripërsëritur Shkëlqesisë Suaj sigurinë e konsideratës sime më të lartë.

Ogerta Manastirliu
MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PROCESVERBAL I DAKORDUAR PËR
DETAJET PROCEDURALE

Referuar shkëmbimit të notave verbale midis Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Përfituesi”) të datës 3 shkurt 2021, në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez që do të shtrihet me qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Shkëmbimi i notave”), përfaqësuesit e Qeverisë së Japonisë dhe të Përfituesit dëshirojnë të regjistrojnë detajet e mëposhtme procedurale, siç është rënë dakord midis autoriteteve të interesuara të Përfituesit dhe Qeverisë së Japonisë:

Referuar shkëmbimit të notave verbale midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Përfituesi”) dhe Qeverisë së Japonisë, të datës 3 shkurt 2021, në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez që do të shtrihet me qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Shkëmbimi i notave”), përfaqësuesit e Përfituesit dhe të Qeverisë së Japonisë dëshirojnë të regjistrojnë detajet e mëposhtme procedurale, siç është rënë dakord midis autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit:

1. Lista e produkteve dhe/ose shërbimeve të pranueshme dhe vendeve me origjinë të pranueshme

Produktet dhe/ose shërbimet e përmendura në nënparagrafin (1) të paragrafit 2 të shkëmbimit të notave verbale (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Produkte” dhe “Shërbime”) dhe vendet me origjinë të pranueshme të përmendura në nënparagrafin (3) të paragrafit 2 të shkëmbimit të notave verbale do të jenë ato të listuara në shtojcën i.

2. Prokurimi

(1) Granti i përmendur në paragrafin 1 të shkëmbimit të notave verbale (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Granti”) dhe interesi i tij rrjedhës do të përdoret për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve, si dhe për tarifat e tilla të domosdoshme për zbatimin e Programit Ekonomik dhe Shoqëror.

(2) Për të siguruar përputhjen me këto kërkesa, kërkohet që Përfituesi të punësojë një agjent të pavarur dhe kompetent për prokurimin e produkteve dhe/ose shërbimeve.

Për këtë arsye, Përfituesi do të lidhë një kontratë pune, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të shkëmbimit të notave verbale, me [Crown Agents Japan Limited] (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Agjenti”) për të vepruar në emër të Përfituesit në përputhje me fushëveprimin e shërbimeve të agjentit siç përcaktohet në shtojcën II.

(3) Kontrata e përmendur e punës do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Qeveria e Japonisë në një formë të shkruar.

(4) Kontratat për blerjen e Produkteve dhe/ose Shërbimeve do të lidhen në jen japonezë midis Agjentit dhe shtetasve Japonezë, përveç nëse është rënë dakord ndryshe ndërmjet autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit (termi “shtetas Japonez” në këtë procesverbal të dakorduar mbi detajet procedurale do të thotë persona fizikë ose persona juridikë japonezë të kontrolluar nga persona fizikë japonezë dhe të regjistruar në Japoni).

(5) Produktet dhe/ose shërbimet do të prokurohen në përputhje me udhëzimet e prokurimit të përcaktuara nga Qeveria e Japonisë, të cilat përcaktojnë, ndër të tjera, procedurat e tenderimit që duhet të ndiqen, përveç kur procedura të tilla janë të pa zbatueshme ose të papërshtatshme.

(6) Përfituesi do të marrë masat e nevojshme për të përshpejtuar përdorimin e grantit dhe interesit të tij rrjedhës, përfshirë lehtësimin e procedurave ekzistuese të importit.

(7) Përfituesi garanton që çdo zyrtar i Përfituesit nuk do të ndërmarrë ndonjë pjesë të punës së shtetasve japonezë dhe/ose punën e shtetasve të vendeve të treta për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve (termi “shtetas i vendeve të treta” në procesverbalin e dakorduar mbi detajet procedurale nënkupton persona fizikë ose juridikë të vendeve të treta).

3. Komisioni

(1) Pas datës së hyrjes në fuqi të shkëmbimit të notave verbale, Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit caktojnë përfaqësuesit e tyre që do të jenë anëtarë të një komisioni konsultativ (në



tekstin e mëposhtëm referuar si “Komisioni”), roli i të cilit do të jetë të diskutojë çdo çështje që mund të lindë nga, ose në lidhje me shkëmbimin e notave verbale. Agjenti cakton përfaqësuesin e tij, i cili do të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit si këshilltar.

(2) Komisioni kryesohet nga përfaqësuesi i Përfituesit. Përfaqësuesit e organizatave të tjera përveç Agjentit, kur është e nevojshme, mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit për të ofruar shërbime këshilluese.

(3) Kushtet e referimit të Komisionit janë siç përcaktohen në shtojcën V.

(4) Takimi i parë i Komisionit do të mbahet midis Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit sa më shpejt që të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të shkëmbimit të notave verbale. Takimet e mëtejshme do të mbahen me kërkesë të Qeverisë së Japonisë, ose të Përfituesit. Agjenti mund të këshillojë Qeverinë e Japonisë dhe Përfituesit për domosdoshmërinë e thirrjes së një mbledhjeje të Komisionit.

4. Procedura e disbursimit

Procedura e disbursimit lidhur me prokurimin e produkteve dhe/ose shërbimeve dhe tarifave të Agjentit sipas Grantit dhe interesit të tij rrjedhës do të jetë si më poshtë:

(1) Përfituesi (ose autoriteti i tij i caktuar) dhe banka në Japoni të përmendur në nënparagrafin (1) të paragrafit 3 të shkëmbimit të notave (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Banka”) do të përfundojnë një marrëveshje në lidhje me transferimin e fondeve, në të cilat Përfituesi do të përcaktojë Agjentin si përfaqësuesin që vepron në emër të Përfituesit në lidhje me të gjitha transferimet e fondeve tek Agjenti.

(2) Agjenti i paraqet Bankës kërkesa për transferimin e fondeve për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për prokurimin e produkteve dhe/ose shërbimeve dhe për shërbimet e lidhura me Agjentin, të përcaktuara në shtojcën II. Secila prej kërkesave shoqërohet me një vlerësim të hollësishëm të shpenzimeve që duhet të mbulohet nga fondet e transferuara dhe një kopje e aprovimit nga Qeveria e Japonisë për kontratën e përmendur në nënparagrafin (3) të paragrafit 2 më lart. Një kopje e kërkesës dhe vlerësimi i dërgohet njëkohësisht edhe Përfituesit.

(3) Në bazë të kërkesës së Agjentit, sipas nënparagrafit (2) më lart, Banka njofton Përfituesin për kërkesën e bërë nga Agjenti. Banka do t'i paguajë shumën Agjentit nga llogaria e përmendur në nënparagrafin (1) të paragrafit 3 të shkëmbimit të notave (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Llogaria”), përveç nëse Përfituesi kundërshton një pagesë të tillë brenda dhjetë ditë pune pas njoftimit nga Banka. Agjenti do të bëjë pagesa për furnitorët e produkteve dhe/ose shërbimeve nga fondet e marra (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Paradhënie”) në përputhje me kushtet e kontratave me ta.

Pas pagesave të tilla, Agjenti mund të përdorë shumën e mbetur të paradhënieve, nëse ka, për prokurimin e produkteve dhe/ose shërbimeve të tjera të pranueshme pa transferuar shumën e përmendur përsëri në llogari.

(4) Kur totali i shumës së mbetur në llogarinë e Agjentit (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Shuma e mbetur”) është më pak se tre për qind (3%) e grantit dhe interesit të tij rrjedhës, Përfituesi mund t'i kërkojë Agjentit të rimbursojë shumën e mbetur të Përfituesit për pagesa që tashmë janë bërë nga Përfituesi për prokurimin e produkteve dhe/ose shërbimeve dhe që nuk janë mbuluar nga granti dhe interesi i tij rrjedhës, me kusht që pagesa të tilla të jenë bërë në ose pas datës së hyrjes në fuqi të shkëmbimit të notave verbale.

Kur Agjenti e gjykon të përshtatshme kërkesën nga Përfituesi, dhe kur lëshohet një vërtetim i prokurimit të pranueshëm për shumën e mbetur e vërtetuar kjo si nga Përfituesi edhe Agjenti, sipas formularit të paraqitur në shtojcën IV, Agjenti do t'i rimbursojë shumën e mbetur Përfituesit.

(5) Në lidhje me pikën (a) të nënparagrafit (1) të paragrafit 5 të shkëmbimit të notave, nuk do të bëhet pagesë e mëtejshme pasi skadon periudha e përmendur në nënparagrafin në fjalë, përveç nëse është rënë dakord ndryshe ndërmjet autoriteteve të interesuara të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

5. Rimbursimi i shumës së mbetur

Në lidhje me pikën (a) të nënparagrafit (1) të paragrafit 5 të shkëmbimit të notave verbale, kur Qeveria e Japonisë konstaton, me marrjen e raportit përfundimtar, se përdorimi i grantit dhe interesit të tij rrjedhës është i paplotë, ajo do të



njoftojë Përfituesin mbi procedurat e rimbursimit të shumës së mbetur në llogari dhe mbi shumën e mbetur. Përfituesi do t'ia kthejë këtë shumë Qeverisë së Japonisë pa vonesë përmes procedurave të tilla siç njoftohet më lart.

Shqipëri (Tiranë), _____

Znj. Ogerta Manastirliu Z. Takada Mitsuyuki

Ministri për Shëndetësinë dhe Mbrotjen Sociale i Republikës së Shqipërisë	Ambasador i Jashtëm dhe Fuqplotë i Japonisë në Shqipëri
--	--

SHTOJCË I

LISTA E PRODUKTEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE TË PRANUESHME DHE VENDEVE ME ORIGJINË TË PRANUESHME

1. Produkte dhe/ose shërbime të pranueshme

(1) Produkte të pranueshme

- Pajisje mjekësore

- Pajisjet përkatëse dhe/ose materialet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore

- Çdo pajisje dhe/ose materiale të kërkuara në vendin/et mjekësor/e në Republikën e Shqipërisë

(2) Shërbime të pranueshme

- Shërbimet e nevojshme për prokurimin dhe transportimin e produkteve të përmendura në pikën 1 (1) më lart.

- Shërbime trajnimi dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore;

- Shërbime këshillimi.

2. Vendet me origjinë të pranueshme

Vendet me origjinë të pranueshme janë të gjitha vendet dhe zonat, përveç Republikës së Shqipërisë.

SHTOJCË II

FUSHËVEPRIMI I SHËRBIMEVE TË AGJENTIT

1. Të sigurojë informacion dhe këshilla për mbledhjet e Komisionit.

2. Të garantojë që Përfituesi dhe përdoruesit fundorë i kuptojnë plotësisht procedurat për t'u përdorur, kur është e nevojshme.

3. (1) Përgatitja e specifikimeve të produkteve dhe/ose shërbimeve për Përfituesin, përfshirë, aty ku është e nevojshme diskutimet e hollësishme me përdoruesit fundorë.

(2) Përgatitja e dokumenteve të duhura të prokurimit për llojin dhe vlerën e produkteve dhe/ose shërbimeve që do të prokurohen.

(3) Shpallja e prokurimit, nëse është e nevojshme, ku dhe si do të mbahet prokurimi, është një çështje për t'u dakorduar midis Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

(4) Vlerësimi i ofertave, përfshirë konsideratat teknike dhe financiare.

(5) Paraqitja për miratim e rekomandimeve të Përfituesit për të vendosur porosinë me furnizuesit.

4. Pranimi dhe shfrytëzimi i paradhënies në përputhje me kontratën e punës me Përfituesin përmendur në nënparagrafin (2) të paragrafit 2 të procesverbalit të dakorduar për detajet procedurale.

5. Bisedimet dhe lidhja e kontratave me furnitorët, përfshirë marrëveshjet e kënaqshme të pagesës, dërgesës dhe inspektimit.

6. Kontrollimi i ecurisë së furnizimeve për të garantuar që datat e dorëzimit janë respektuar.

7. Pajisja e Përfituesit dhe përdoruesve fundorë me dokumente që përmbajnë informacion të hollësishëm mbi ecurinë e porosive, njoftimin e porosive të vendosura, ndryshimet e kontratave, informacionin e dorëzimit, dokumentet e transportit etj.

8. Pagesat e furnitorëve nga paradhëniet.

9. Ofrimi i dokumenteve të mëposhtme Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit:

(1) Vërtetimi i prokurimit të pranueshëm sipas shtojcës III

(2) Fatura e proforma

10. Përgatitja e raporteve tremujore të statusit për të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit, duke



përfshirë pyetjet, porositë, statusin e porosisë, vlerat dhe informacionin e dorëzimit.

11. Paraqitja e deklaratave tremujore të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit që paraqesin me hollësi bilancin ndaj grantit dhe interesit të tij rrjedhës dhe të gjitha disbursimet për tremujorin.

12. Paraqitja e një raporti të përgjithshëm vlerësimi të Qeveria e Japonisë, duke përfshirë hollësi për të gjitha produktet dhe/ose shërbimet e transportuara, vendin e origjinës, datën e dorëzimit, vlerën e produkteve dhe/ose shërbimeve (përfshirë tarifën përkatëse) dhe shumat totale të disbursuara dhe të mbetura.

SHTOJCË III VËRTETIMI I PROKURIMIT TË PRANUESHËM

Data:
Nr. ref.

Atij që mund t'i interesojë:

Referuar faturës proforma bashkëlidhur, vërtetojmë se prokurimi është në përputhje me të gjitha termet dhe kushtet përkatëse të shkëmbimit të notave verbale midis Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të datës 3 shkurt 2021, dhe procesverbalit të dakorduar për detajet procedurale midis Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit të datës 3 shkurt 2021.

Më poshtë janë faktet kryesore në lidhje me prokurimin.

1. Metoda e prokurimit
(Vendosni X në vendin e duhur)
 - a) _____ : ofertat konkurruese
 - b) _____ : ofertat e kufizuara
 - c) _____ : blerje
 - d) _____ : kontraktim i drejtpërdrejtë
2. Produkte dhe/ose shërbimet
 - a) emri i produkteve dhe/ose shërbimeve:
 - b) origjina:
3. Kosto e produkteve dhe/ose shërbimeve
 - a) produktet dhe/ose shërbimet:
 - b) transporti i mallrave:
 - c) sigurimi detar:
 - d) tarifën e Agjentit:
 - e) totali (a+b+c+d):

4. Furnizuesi
 - a) emri:
 - b) adresa:
 - c) Kombësia:
(vendi ku është përfshirë dhe regjistruar furnizuesi)
5. Marrësi i ngarkesës
 - a) emri:
 - b) adresa:

(firmë)

Agjenti
Emri Mbiemri dhe Titulli

SHTOJCË IV VËRTETIMI I PROKURIMIT TË PRANUESHËM PËR SHUMËN E MBETUR (PROCEDURA E RIMBURSIMIT)

Data:
Nr. ref.

Lidhur me urdhrin e pagesës, i nënshkruari si vijon vërteton se prokurimi në lidhje me urdhrin e pagesës në fjalë, siç është renditur më poshtë, është në përputhje me të gjitha termet dhe kushtet përkatëse të shkëmbimit të notave midis Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të datës 3 shkurt 2021 dhe procesverbalit të dakorduar mbi detajet procedurale midis Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të datës 3 shkurt 2021.

Përfaqësuesi i nënshkruar i Përfituesit vërteton më tej se Përfituesi nuk ka aplikuar deri më tani për rimbursim në bazë të shkëmbimit të notave në fjalë, dhe as për ndonjë mënyrë tjetër financimi me burime të tjera të ndihmës zyrtare në lidhje me secilën nga shumat e kërkuara për rimbursim siç justifikohet në urdhrin e pagesës.

Më poshtë janë faktet kryesore në lidhje me prokurimin.



1. Transaksioni	2. Blerësi	3. Furnizuesi (emri)	4. Kombësia e furnizuesit	5. Produktet dhe/ose shërbimet	6. Origjina	7. Data e pagesës	8. Shuma e pagesës	9. Metoda e prokurimit
1.								
2.								
3.								
4.								

Dokumentet e mëposhtme (në një kopje) janë bashkëlidhur për secilën nga transaksionet e mësipërme:

- a) letër shoqëruese e bankës negociuese/paguese;
- b) fatura e ngarkesës së mallrave, pranimi i pakove me postë ose fletëdërgimi i mallrave me transport ajror;
- c) fatura.

Firma e autorizuar
(Përfituesi)
Emri, Mbiemri dhe Titulli

Firma e autorizuar
(Agjenti)
Emri, Mbiemri dhe Titulli



SHTOJCË V
KUSHTET E REFERENCËS SË
KOMISIONIT

1. Të formulojë një plan të detajuar me afate kohore për shfrytëzimin e shpejtë dhe efektiv të Grantit dhe interesit të tij rrjedhës.

2. Të shkëmbejnë mendime mbi shpërndarjet e Grantit dhe interesit të tij rrjedhës, si dhe për përdoruesit e mundshëm fundorë.

3. Të identifikojë problemet që mund të vonojnë përdorimin e Grantit dhe interesit të tij rrjedhës dhe të gjejë zgjidhje për probleme të tilla.

4. Të shkëmbejnë mendime mbi publicitetin në lidhje me përdorimin e Grantit dhe interesit të tij rrjedhës.

5. Të diskutojë çdo çështje tjetër që mund të lindë nga ose në lidhje me shkëmbimin e notave.

PROCESVERBALI I DISKUTIMEVE

Referuar shkëmbimit të notave verbale midis Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Përfituesi”) të datës 3 shkurt 2021, lidhur me bashkëpunimin ekonomik japonez që do të shtrihet me qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Shkëmbimi i notave”), përfaqësuesit e Delegacionit Japonez dhe të Delegacionit Shqiptar dëshirojnë të regjistrojnë sa vijon:

Referuar shkëmbimit të notave verbale midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Përfituesi”) dhe Qeverisë së Japonisë, të datës 3 Shkurt 2021, lidhur me bashkëpunimin ekonomik japonez që do të shtrihet me qëllim promovimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Shkëmbimi i notave”), përfaqësuesit e Delegacionit Shqiptar dhe të Delegacionit Japonez dëshirojnë të regjistrojnë sa vijon:

1. Në lidhje me paragrafin 2 të shkëmbimit të notave, përfaqësuesi i Delegacionit Japonez deklaroi se Qeveria e Japonisë e kupton, që:

a) Përfituesi do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar çdo ofertë, dhuratë ose pagesë, konsideratë ose përfitim që do të interpretohet si një praktikë korruptive në vendin e Përfituesit nga

nxitja ose shpërblimi në lidhje me dhënien e kontratave që agjenti i përmendur në nënparagrafin (2) të paragrafit 2 të procesverbalit të dakorduar për detajet procedurale të shkëmbimit të notave do të kryejë në funksion të blerjes së produkteve dhe/ose shërbimeve të përmendura në paragrafin 2 të shkëmbimit të notave; dhe

b) Përfituesi do t'i kthejë Qeverisë së Japonisë, nëse ndodh praktika korruptive e përmendur në nënparagrafin (a) më lart, shumën e grantit të përmendur në paragrafin 1 të shkëmbimit të notave (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Granti”) ekuivalent me shumën e shpenzuar në një praktikë të tillë korruptive, e cila përcaktohet nga Qeveria e Japonisë.

2. Në lidhje me nënparagrafin (2) të paragrafit 5 të shkëmbimit të notave, përfaqësuesi i Delegacionit Japonez deklaroi se Qeveria e Japonisë e kupton, që:

a) informacioni i nevojshëm përfaqëson informacione mbi praktikën korruptive që lidhen me Grantin; dhe

b) Përfituesi do të garantojë një trajtim të drejtë të burimeve të tilla të informacionit.

3. Përfaqësuesi i Delegacionit Shqiptar deklaroi se Delegacioni Shqiptar nuk ka kundërshtim për deklaratën e përfaqësuesit të Delegacionit Japonez të përmendur më lart.

Shqipëri (Tiranë), _____

Znj. Ogerta Manastirliu

Ministri për Shëndetësinë
dhe Mbrojtjen Sociale i
Republikës së Shqipërisë

Z. Takada Mitsuyuki

Ambasador i Jashtëm dhe
Fuqiplotë i Japonisë në
Shqipëri



URDHËR

Nr. 117, datë 19.2.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 23, DATË 18.1.2021, “PËR
MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONEVE MJEKËSORE TË
CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË,
TË NIVELIT TË PARË EPROR, PËR
VLERËSIMIN E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 4, pika 3, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar; të pikave 2 dhe 7, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal”,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 23, datë 18.1.2021, “Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, të nivelit të parë epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara”, bëhen ndryshimet si vijon:

Në pikën 2, germa “d”, Komisioni (KMCAP/KMVP) për para/tetraplegji, pas germës “iii”, shtohet germa “iii/1 Z. Bujar Cakani (Neurolog)”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 136, datë 25.2.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 100, DATË 10.2.2021 “PËR KUFIZIMIN
E AKTIVITETEVE TË BAREVE,
RESTORANTEVE, *FAST FOOD*-ve
DHE LOKALEVE”**

Në zbatim të nenit 7, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809/4, datë 25.2.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 100, datë 10.2.2021 “Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, *fast food*-ve dhe lokaleve”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrin togfjalësh “deri në datën 25.2.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në një urdhër të dytë”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR

Nr. 137, datë 25.2.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 99, DATË 10.2.2021 “PËR KUFIZIMIN
E LËVIZJES BRENDA VENDIT”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 4, gjerat “d”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, sipas udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809/4, datë 25.2.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,



URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021 “Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit togfjalëshi “deri në datën 25.2.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në një urdhër të dytë”.

2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 7576317

Fatbardh Budo kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur në datën 12 janar 2021, si Komitet i përbërë nga:

Dmitry Dedov, president,

Darian Pavli,

Peter Roosma, gjykatës,

dhe Olga Chernishova, zëvendës regjistruese e seksionit,

duke pasur parasysh kërkesën e mësipërme të depozituar në datën 18 tetor 2017, duke pasur parasysh deklaratat zyrtare që pranojnë një zgjidhje me mirëkuptim të çështjes,

pas shqyrtimit të çështjes, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

1. Kërkesi, z. Fatbardh Budo, është një shtetas shqiptar i cili ka lindur në vitin 1975 dhe jeton në Gjirokastrë. Ai u përfaqësua para Gjykatës nga z. F. Caka, një avokat që ushtron profesionin në Tiranë.

2. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjenti i tyre i atëhershëm, z. A. Metani dhe më pas nga znj. E. Muçaj nga zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Kërkesi, i cili ishte një i burgosur i dënuar, u ankua për shkelje të nenit 3, të Konventës në lidhje me përdorimin e prangave në një mjedis spitalor

dhe të nenit 13, për mungesën e një mjeti efektiv juridik për ankesën e tij sipas nenit 3.

4. Çështja iu komunikua Qeverisë më 18 dhjetor 2019.

6. Më 3 dhjetor 2020, Gjykata mori një deklaratë nga Qeveria në lidhje me një zgjidhje të çështjes me mirëkuptim, e cila përmban tekstin e mëposhtëm:

“Me anë të kësaj deklaroi se Qeveria e Shqipërisë ofron të paguajë *ex gratia*, me qëllim që të sigurojë një zgjidhje me mirëkuptim të çështjes së lartpërmendur, të mbetur pezull para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 10.000 euro (dhjetë mijë euro) për kërkuesin ... për të mbuluar çdo dhe të gjithë dëmin material dhe jomaterial, si edhe 700 euro (shtatëqind euro) në lidhje me kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t’i ngarkohet kërkuesit.

2. Shumat e mësipërme do të paguheshin brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të dhënë nga Gjykata, në përputhje me nenin 39 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga mbarimi i periudhës së lartpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje. Kjo pagesë do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

3. Qeveria shpreh sinjerisht keqardhje që kërkuesi u mbajt i prangosur në një shtrat spitali dhe pranon se rrethanat e çështjes në fjalë tregonin një problem sistematik dhe strukturor, specifikisht përdorimi i prangave për të lidhur një të burgosur në një shtrat spitali, i cili ishte parashikuar në rregullat e hollësishme në lidhje me sjelljen e oficerëve të policisë në burg (2010).

4. Kjo praktikë, përkatësisht përdorimi standard i prangave në një mjedis spitalor, është ndërprerë që nga data 31 korrik 2018. Gjithashtu, dy akte ligjore të kohëve të fundit, përkatësisht ligji për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve (ligji nr. 81/2020) dhe ligji për policinë e burgjeve (ligji nr. 81/2020) u miratuan në vitin 2020 dhe vunë theksin në kryerjen e një vlerësimi të rrezikut, duke përfshirë vlerësimin e nivelit të rrezikshmërisë së çdo të burgosuri, përpara zbatimit të ndonjë mase kufizuese.

5. Qeveria më tej merr përsipër të:

- ndryshojë legjislacionin dytësor zbatues ekzistues dhe të miratojë legjislacionin e ri dytësor,



në zbatim të ligjeve të mësipërme, duke përfshirë miratimin e rregullave të reja në lidhje me sjelljen e oficerëve të policisë në burg, brenda një viti nga data e vendimit të Gjykatës;

- marrë masa për krijimin e njësisë të specializuara brenda institucioneve të përshtatshme shëndetësore me elemente të përmirësuar sigurie, që do të plotësojnë nevojat e sigurisë dhe do të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të burgosurve;

- zhvillojë seminare trajnimi dhe ndërgjegjësimi me oficerë të policisë së burgjeve dhe autoritete të tjera përkatëse mbi legjislacionin e miratuar së fundi, me qëllim që të garantojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.”.

7. Më 8 dhjetor 2020, Gjykata mori një deklaratë të nënshkruar nga kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij në lidhje me një zgjidhje me mirëkuptim të çështjes, pjesa më e rëndësishme e të cilës përmbante tekstin e mëposhtëm:

“2 pranon propozimin e bërë nga Qeveria dhe heq dorë nga çdo pretendim i mëtejshëm kundër Shqipërisë në lidhje me faktet e kësaj kërkesë. Unë deklaroj se pagesa e shumës së mësipërme përbën zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.”.

LIGJI

8. Gjykata konstaton zgjidhjen me mirëkuptim të arritur ndërmjet palëve. Ajo është e bindur se zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në Konventë dhe Protokollin e saj dhe nuk vëren asnjë arsye për të justifikuar vijimin e shqyrtimit të kërkesës (neni 37§1 *in fine* i Konventës). Sa më sipër, është e nevojshme që çështja të fshihet nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA
UNANIMISHT:

Vendos të fshijë kërkesën nga lista e çështjeve të saj në përputhje me nenin 39 të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim në datën 4 shkurt 2021.

Olga Chernishova
ZËVENDËS
REGJISTRUES

Dmitry Dedov
PRESIDENT

VENDIM Nr. 1, datë 26.2.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha, kryetare e Gjykatës Kushtetuese

Marsida Xhaferllari, anëtare e “ “

Fiona Papajorgji, anëtare e “ “

Altin Binaj, anëtar i “ “

Përparim Kalo, anëtar i “ “

Sonila Bejtja, anëtare e “ “

Elsa Toska, anëtare e “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 26.1.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 1 akti, që u përket:

KËRKUESE: GJYKATA E RRETHIT
GJYQËSOR TIRANË

SUBJEKTE TË INTERESUARA: KUVENDI
I SHQIPËRISË, KËSHILLI I MINISTRAVE,
PROKURORIA E PËRGJITHSHME

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i togfjalëshit “nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit” të pikës 1 të nenit 453 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe togfjalëshit “... i së njëjtës gjykatë” të pikës 3 të nenit 453 të KPP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 34, 116, 135 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Prokurorisë së Përgjithshme, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 11.9.2018 me kërkesën nr. G-11 prot. për konstatimin e kushtetutshmërisë së pikave 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së. Sipas kësaj kërkesë rezulton se me vendimin nr. 1418, datë 2.11.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit A.M. për veprën penale “Mashttrim që ka sjellë pasoja të rënda” dhe në bazë të neneve 143, paragrafi i dytë dhe 49 të Kodit Penal (KP) e ka dënuar atë me 10 vjet burgim. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 12.11.2010. Ky proces rezulton të jetë bërë në mungesë të të pandehurit A.M., me mbrojtës të caktuar kryesisht dhe njoftimi për të është bërë me shpallje, pasi nuk është gjendur. Ndodhur në këto kushte, i pandehuri i është drejtuar gjykatës me kërkesë për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 450/1, shkronja “c” të KPP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë shqyrtimit të çështjes, duke vlerësuar se pikat 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së bien ndesh me Kushtetutën, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës. Në datën 20.12.2019 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

2. Në datën 20.3.2019 në Gjykatën Kushtetuese është regjistruar një kërkesë tjetër e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr.G-3 prot., me të njëjtin objekt. Sipas kësaj kërkesë rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 31, datë 31.1.2000, ndër të tjera, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit M.P. për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 333, 79/c, 22, 76 dhe 110/2 të KP-së dhe në bazë të nenit 55 të KP-së, dënimin e tij përfundimisht me burgim të përjetshëm. Për ankimin e të bashkëpandehurve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 222, datë 24.5.2000, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi. Po për rekursin e të bashkëpandehurve, Gjykata e Lartë

ka vendosur mospranimin e tij. Duke qenë se shtetasi M.P. është gjykuar në mungesë, nëpërmjet përfaqësuesve të tij ka kërkuar rishikimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 450/1, shkronja “e”, të KPP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë shqyrtimit të çështjes, duke vlerësuar se pikat 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së bien ndesh me Kushtetutën, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës. Në datën 8.1.2020 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

3. Në datën 14.5.2019 në Gjykatën Kushtetuese është regjistruar një kërkesë e ardhur përsëri nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr.G-4 prot., me të njëjtin objekt. Sipas kësaj kërkesë rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3013, datë 10.11.2017, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit F.F. për kryerjen e veprës penale “Mosbindja ndaj urdhrat të ligjshëm të punonjësit të rendit publik” dhe dënimin e tij me dy muaj burgim. Ndaj këtij vendimi rezulton se nuk është paraqitur ankim. Shtetasi F.F. është ndaluar në kufi në datën 11.4.2019 dhe në vijim është bërë ekzekutimi i vendimit gjyqësor penal të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shtetasi F.F. nëpërmjet avokatit të tij ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesë me objekt rishikimin e këtij vendimi, për arsye se vendimi ndaj tij ishte dhënë në mungesë, bazuar në nenin 450/1, shkronja “e”, të KPP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë shqyrtimit të çështjes, duke vlerësuar se pikat 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së bien ndesh me Kushtetutën, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës. Në datën 8.1.2020 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

4. Gjithashtu, në datën 10.2.2020 në Gjykatën Kushtetuese është regjistruar një kërkesë tjetër e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. G-1 prot., me të njëjtin objekt. Sipas kësaj kërkesë rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1646, datë 31.5.2018, ka



vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit I.K. për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, e mbetur në tentativë dhe bazuar në nenet 78, paragrafi 1 dhe 22 të KP-së, dënimin e tij me 16 vjet burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 3.10.2018, pasi nuk është ankimuar nga përfaqësuesi i të pandehurit. Mbi këtë bazë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin për ekzekutim, i cili është ekzekutuar në Francë në datën 21.1.2020. Shtetasi I.K., bazuar në nenin 352 të KPP-së, me pretendimin se është gjykuar në mungesë, i është drejtuar gjykatës për rishikimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 450/1, shkronja “e”, të KPP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë shqyrtimit të çështjes, duke vlerësuar se pikat 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së bien ndesh me Kushtetutën, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës. Në datën 18.2.2020 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

5. Në datën 18.9.2020 në Gjykatën Kushtetuese është regjistruar një kërkesë tjetër e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr.G-6 prot., me të njëjtin objekt. Sipas kësaj kërkesë rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 430 të vitit 2018, midis të tjerash, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit E.K. për kryerjen e veprës penale “Mosdhënia e mjeteve për jetesë” dhe bazuar në nenin 125 të KP-së, dënimin e tij me 9 (nëntë) muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 2.7.2018, pasi nuk është ankimuar nga i pandehuri. Mbi këtë bazë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal. Përfaqësuesi i të pandehurit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për rishikimin e këtij vendimi, duke pretenduar se është gjykuar në mungesë, bazuar në nenin 450, shkronja “e”, të KPP-së, e cila është vënë në lëvizje për shqyrtimin e kësaj kërkesë, duke vlerësuar se pikat 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së bien ndesh me Kushtetutën, dhe ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes, si dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e

kushtetutshmërisë së normës. Në datën 9.10.2020 Kolegji e Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

6. Në datën 7.1.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur bashkimin e kërkesave të paraqitura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjykata referuese) në një çështje të vetme.

II

Pretendimet e palëve

7. **Gjykata referuese** i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e dispozitave të KPP-së, sipas objektit të kërkesës, duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur:

7.1. Në rastin konkret plotësohen kushtet e legjitimitetit në gjykimin kushtetues. Para gjykatës referuese janë paraqitur kërkesa për rishikimin e vendimeve penale të formës së prerë, ndaj kushtetutshmëria ose jo e dispozitave të kundërshtuara të nenit 453 të KPP-së, të ndryshuara me ligjin nr. 35/2017, është element thelbësor që kushtëzon drejtpërdrejt dhënien e një vendimi përfundimtar në lidhje me çështjen objekt gjykimi. Për shkak të qartësisë së kësaj dispozite dhe praktikës së konsoliduar gjyqësore nuk ekziston asnjë mundësi që kjo dispozitë të interpretohet në harmoni me dispozitat kushtetuese, të cilat gjykata referuese vlerëson se cenohen. Për rrjedhojë, plotësohet parakushti që kushtetutshmëria e normës të jetë *conditio sine qua non* për zgjidhjen e çështjes konkrete.

7.2. *Cenohet parimi i rigjyimit të çështjes “nga një gjykatë më e lartë”*, sipas nenit 34 të Kushtetutës, që është një dispozitë që zbatohet drejtpërdrejt lidhur me faktin se cila është gjykata kompetente për të vendosur rigjykimin. Në këto kushte, parashikimi ligjor se kompetente për të gjykuar kërkesën për rishikim është gjykata e shkallës së parë, që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit, bie në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, i shprehur në përparësinë e normave të Kushtetutës në raport me normat e tjera ligjore. Për rrjedhojë, pikat 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së bien ndesh me nenet 4, 34, 116, 135 dhe 145 të Kushtetutës.



7.3. *Cenohet parimi i pavarësisë* në drejtim të kontrollit të shkallëzuar gjyqësor, sipas të cilit vendimet gjyqësore të gjykatave më të ulëta kontrollohen nga ato më të larta, në përputhje me nenet 135 dhe 145 të Kushtetutës. Dispozitat objekt kundërshtimi parashikojnë se një trup gjykues i së njëjtës shkallë mund të kontrollojë një vendim të gjykuar nga një tjetër trup gjykues i së njëjtës shkallë gjykimi.

8. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, duke pretenduar se dispozitat e KPP-së të kundërshtuara nga gjykata referuese janë në përputhje me Kushtetutën, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar sa vijon:

8.1. Gjkata referuese në disa raste të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, në lidhje me çështjen objekt kërkesë, nuk legjitimohet për të iniciuar gjykimin incidental. Vendimet e formës së prerë, të cilat kërkojnë të rishikohen, janë marrë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, ndaj ajo duhet të përdorte mjetet ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën kur është marrë vendimi i formës së prerë, të cilat janë favorizuese për të. Gjkata referuese, përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, duhet të hetonte nëse kishte dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim. Në rastin konkret janë dispozitat e KPP-së para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017. Për rastet e tjera ajo legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

8.2. Rregullimi ligjor i rishikimit me ligjin nr. 35/2017 është bërë domosdoshmëri pas ndryshimit në Kushtetutë të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë. Kalimi i kompetencës rishikuese gjykatës së shkallës së parë është bërë në kushtet kur Gjkata e Lartë është vetëm gjykatë ligji, pra gjykatë që kontrollon mënyrën e respektimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural, dhe rishikimi sipas ligjit procedural parashikohet si një mjet i veçantë ankimi.

8.3. Nuk cenohet procedura e rishikimit, pasi ligjvënësi ka përcaktuar se gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin është gjykata që do të shqyrtojë kushtet formale të kërkesës për rishikim, por do të jetë një trup tjetër gjykues, po në gjykatën e shkallës së parë ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj, që do të shqyrtojë themelin e kërkesës. Lejimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës rishikuese garanton parimin se pushteti

gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar, sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga ato më të larta.

9. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, duke pretenduar se dispozitat e KPP-së të kundërshtuara nga gjykata referuese janë në përputhje me Kushtetutën, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar sa vijon:

9.1. Gjkata referuese nuk legjitimohet në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk plotëson kushtet që ka parashikuar neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr.8577/2000. Gjkata referuese nuk ka përcaktuar dispozitën materiale që do të zbatohet në zgjidhjen e çështjes konkrete, nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar normën, si dhe nuk ka parashtruar argumente serioze për jokushtetutshmërinë e saj. Për rrjedhojë, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes, pasi dispozitat janë të natyrës procedurale dhe nuk sjellin asnjë efekt ose ndikim në shqyrtimin e çështjes.

9.2. Termi “rigjykim”, sipas nenit 34 të Kushtetutës, i referohet rigjykimit të çështjeve, sipas kuptimit të dhënë nga Kodi i Procedurës Civile (KPC) dhe KPP-ja, i cili është tërësisht i ndryshëm nga instituti i rishikimit të vendimeve të formës së prerë. Për pasojë, pretendimi i gjykatës referuese se dispozitat objekt gjykimi janë në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës, është i pabazuar.

9.3. Në rastin hipotetik të shfuqizimit të normës do të gjendemi përpara një vakumi ligjor në drejtim të gjykatës kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rishikim, duke pasjellë cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë për individët. Në rast riformulimi të dispozitës, duke përcaktuar në rastin hipotetik se kërkesa për rishikim shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë se ajo që ka dhënë vendimin, përsëri dispozita do të ishte e paqartë në rastin e rishikimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë. Si pasojë, Gjkata mund të kryejë interpretimin pajtues të dispozitës dhe jo shfuqizimin e saj si antikushtetuese.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, duke pretenduar se dispozitat e KPP-së të kundërshtuara nga gjykata referuese janë në përputhje me Kushtetutën, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar sa vijon:



10.1. Pretendimet e gjykatës referuese janë të pabazuara, pasi dispozitat objekt kërkesë nuk bien ndesh me ndonjë normë tjetër kushtetuese, për më tepër janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

10.2. Instituti i rishikimit përbën një diskriminim pozitiv të individit, si për sa i përket thelbit ashtu edhe procedurës, duke i njohur të drejtën gjykatës, që ka dhënë vendimin si gjykatë e shkallës së parë, të korrigjojë vendimin e vet dhe të marrë vendim në kushtet e evidentimit të elementeve të faktit që kanë qenë objektivisht të pamundura të administrohen në gjykimin e parë.

10.3. Gjykata referuese duhet të trajtonte në kërkesën e saj kushtetutshmërinë e shkronjave “d”, “dh” dhe “e” të nenit 450 të KPP-së. Vetëm në këtë rast do të kishte vlerë diskutimi për kushtetutshmërinë, pasi një analizë e tillë do të çonte në konkluzionin nëse janë ndryshimet e bëra në lidhje me kompetencën, që cenojnë rendin juridik ose shkaqet e kërimit të rishikimit. Duke analizuar se shkaqet sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç” të nenit 450 të KPP-së janë kërime bazuar në kontrollin e faktit, kurse shkaqet e parashikuara në shkronjat “d”, “dh” dhe “e” të nenit 450 të KPP-së janë parashikime bazuar mbi kontrollin e ligjit, atëherë dhe kërkesja do të ofronte arsye për antikushtetutshmërinë e normës.

10.4. Ndryshimi i kompetencës së dhënë gjykatës së shkallës së parë do të binte ndesh me të gjithë korpusin e dispozitave, që nëpërmjet ndryshimeve kanë synuar ta kthejnë Gjykatën e Lartë në gjykatë ligji.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

11. Gjykata vlerëson të theksojë se prej datës 23 mars të vitit 2018 ajo nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për formimin dhe funksionimin e shqyrtimit të çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e këtyre çështjeve në seancë plenare.

A. Për legjitimitetin e gjykatës referuese

12. Neni 145, pika 2 dhe neni 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës u njohin të drejtën gjyqtarëve që gjatë gjykimin, kur ata çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën, të

mos i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese.

13. Gjykata, bazuar në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, i konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese për inicimin e kontrollit incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: (i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; (ii) të parashtrojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; (iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; (iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr.26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka pretenduar se gjykata referuese nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi në disa raste të paraqitura përpara kësaj Gjykate, vendimet e formës së prerë që kërkojnë të rishikohen janë marrë përpara se të hynin në fuqi dispozitat e ligjit nr. 35/2017, ndaj ajo duhej të përdorte mjetet ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën kur është marrë vendimi i formës së prerë, të cilat janë favorizuese për të. Gjykata referuese, përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese, duhej të hetonte nëse kishte dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në shqyrtim, që në rastin konkret janë dispozitat procedurale para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017.

15. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar duke argumentuar se gjykata referuese nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar normën, si dhe nuk ka parashtuar argumente serioze për jokushtetutshmërinë e saj.

16. Bazuar në materialet e dërguara kësaj Gjykate nga gjykata referuese, së bashku me vendimin për pezullimin e gjykimin të çështjeve, rezulton se ajo është vënë në lëvizje për shqyrtimin e kërkesave për rishikimin e vendimeve penale të formës së prerë, dhënë nga



Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (*shih paragrafët 1-5 të këtij vendimi*), ku kërkuesit kanë qenë të gjithë të gjykuar në mungesë dhe kërkojnë rishikim të vendimeve bazuar në shkronjën “e” të nenit 450/1, si dhe në një rast në shkronjën “c” të po këtij neni të KPP-së (*prg.1 i vendimit*).

17. Në nenin 453, pika 1 parashikohet se gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës është gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin dhe se kërkesa shqyrtohet në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve. Sipas pikës 2 të këtij neni, kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 450 ose rezulton haptazi e pambështetur, vendoset mospranimi i saj. Ndërsa, sipas pikës 3 të po këtij neni, kur kërkesa pranohet, gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim nga një trup tjetër gjykues i së njëjtës gjykatë ose në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj. Gjykata referuese ka kundërshtuar pikërisht përmbajtjen e pikave 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së, duke pretenduar se ato bien ndesh me normat kushtetuese.

18. Në kuptim të kriterëve për legjitimitimin e gjykatës referuese, Gjykata vlerëson se dispozitat e kundërshtuara janë të zbatueshme në procedurat që duhet të ndiqen prej saj në zgjidhjen e çështjes konkrete. Gjykata referuese ka identifikuar lidhjen e drejtpërdrejtë mes dispozitës së kundërshtuar dhe nevojës për përdorimin e saj në zgjidhjen e çështjes konkrete dhe ka argumentuar se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së normës nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, ajo ka parashtruar edhe argumentet kushtetuese ku e mbështet kërkesën e saj.

19. Në lidhje me pretendimin e subjektit të interesuar, Kuvendit, se gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi ajo duhet të zbatonte dispozitat procedurale penale që ishin në fuqi në kohën kur janë marrë vendimet gjyqësore të formës së prerë që kërkohen të rishikohen, pra KPP-së, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, Gjykata vlerëson se ky pretendim është i pabazuar. Edhe pse Kushtetuta nuk përmban një rregull të veçantë për zbatimin në kohë të ligjit, me përjashtim të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues (neni 29, pika 3) dhe ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit për taksat, tatimet dhe

detyrimet financiare (neni 155), zbatimi i ligjit në kohë lidhet me shtetin e së drejtës dhe procesin e rregullt ligjor, në kuptimin që siguria juridike kërkon që kushdo të jetë në gjendje të parashikojë se si zbatohet ligji në një situatë të caktuar. Për sa i takon zbatimin në kohë të ligjit procedural penal, Gjykata thekson se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ai zbatohet në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur edhe më parë se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 11, datë 23.4.2009; nr. 106, datë 27.5.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke iu referuar nenit 285 të ligjit nr.35/2017 (dispozitave kalimtare), rezulton se nuk ka asnjë përjashtim ose përcaktim lidhur me zbatimin e ligjit të vjetër. Gjykata konstaton se të gjitha kërkesat për rishikim janë depozituar pranë gjykatës të shkallës së parë pas datës 1 gusht të vitit 2017, kohë kur hyri në fuqi ligji nr. 35/2017 me ndryshimet përkatëse. Për pasojë, në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje në gjykatën referuese, zbatoheshin dispozitat e reja të KPP-së, të ndryshuara me ligjin nr. 35/2017.

21. Për sa i përket pretendimit të subjektit tjetër të interesuar, Këshillit të Ministrave, se gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi dispozitat ligjore të dërguara për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese kanë karakter procedural dhe nuk sjellin efekt ose ndikim në zgjidhjen e çështjes prej saj, Gjykata vlerëson se është i pabazuar. Neni 145, pika 2, i Kushtetutës, i lidhur me nenin 68, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, nuk bëjnë asnjë përjashtim të shprehur për ligjet me natyrë procedurale, por ashtu siç është konfirmuar nga jurisprudenca kushtetuese, kërkojnë që ligji i dërguar për shqyrtim të ketë lidhje me gjykimin pranë gjykatës referuese në atë masë që ky gjykim nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese kushtetutshmëria e ligjit të dërguar. Parë në këtë këndvështrim, duhet evidentuar se ligji procedural shërben për të disiplinuar zhvillimin e procesit të rregullt, në funksion të përcaktimit të fakteve, identifikimit dhe zbatimit të ligjit material për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Për më tepër, Gjykata thekson faktin se edhe në të



kaluarën ka pasur si objekt të shqyrtimit të saj raste të gjykimit incidental të normave, ku objekt kërkesë kanë qenë norma ligjore procedurale (*shih vendimet nr. 26, datë 22.5.2015; nr. 30, datë 25.5.2015; nr. 62, datë 4.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, Gjykata vëren se në të gjitha kërkesat gjykata referuese është vënë në lëvizje nga kërkesa për rishikim e të pandehurve kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë që kanë vendosur fajësinë e tyre. Bazuar në pikën 3 të nenit 453 të KPP-së, kompetenca e gjykatës referuese, nëse arrin në përfundimin se kërkesa për rishikim do të pranohet, është të vendosë dërgimin e çështjes për rigjykim një tjetër trupi gjykues të së njëjtës shkallë (Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në rastet në shqyrtim). Për pasojë, Gjykata vlerëson se bazuar në nenin 48, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, gjykata referuese nuk legjitimohet në lidhje me pretendimet për dërgimin e çështjes për rigjykim nga gjykata e shkallës së parë në gjykatën e apelit, pasi nuk gjendet në asnjë nga rastet që ka për shqyrtim përpara saj. Në përfundim, Gjykata çmon se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitit, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000, vetëm në rastet e dërgimit të çështjes për rigjykim nga një trup gjykues në një tjetër të së njëjtës shkallë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të rigjykimit të çështjes “nga një gjykatë më e lartë”

23. Gjykata referuese pretendon se parashikimi ligjor se kompetente për të gjykuar kërkesën për rishikim është gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit, bie në kundërshtim me nenin 34 të Kushtetutës, pasi askush nuk mund të gjykohej sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Në këto kushte, ky parashikim ligjor bie në kundërshtim edhe me parimin e shtetit të së drejtës, i shprehur në përparësinë e normave të Kushtetutës në raport me normat e tjera ligjore, bazuar në nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës.

24. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, prapëson se neni 453 i KPP-së ka ndryshuar vetëm gjykatën e rishikimit, duke ia dhënë këtë kompetencë gjykatave të shkallës së parë. Ky

rregullim është bërë domosdoshmëri pas ndryshimit në Kushtetutë të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, në kushtet kur Gjykata e Lartë është vetëm gjykatë ligji.

25. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, prapëson se termi “rigjykim” në nenin 34 të Kushtetutës i referohet rigjykimit të çështjeve, sipas kuptimit të dhënë nga KPC-ja dhe KPP-ja, i cili është tërësisht i ndryshëm nga instituti i rishikimit të vendimeve të formës së prerë. Në rast riformulimi të dispozitës, duke përcaktuar në rastin hipotetik se kërkesa për rishikim shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë se ajo që ka dhënë vendimin, përsëri dispozita do të ishte e paqartë në rastin e rishikimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë.

26. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në parashtrimet e paraqitura pranë Gjykatës, argumenton se pretendimet e kërkuësës janë të pabazuara, për faktin se dispozitat objekt kërkesë nuk bien ndesh me ndonjë normë tjetër kushtetuese, e, për më tepër, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Instituti i rishikimit përbën një diskriminim pozitiv për individin, si për sa i përket thelbit, ashtu edhe për sa i përket procedurës. Ndryshimi i kompetencës do të binte ndesh me të gjithë korpusin e dispozitave, që nëpërmjet ndryshimeve kanë synuar ta kthejnë Gjykatën e Lartë në gjykatë ligji.

27. Në lidhje me parimin e shtetit të së drejtës, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se ky parim detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 1, datë 12.1.2011; nr. 23, datë 8.6.2011; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo, për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem



harmonik. Natyra e Kushtetutës, koncepti i kushtetutshmërisë, nënkupton që Kushtetuta nuk mund të ketë kontradikta të brendshme. Për pasojë, asnjë dispozitë e saj nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (*shih vendimin nr. 2, datë 19.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Nisur nga pretendimet e gjykatës referuese që lidhen me nenin 34 të Kushtetutës, Gjykata do të ndalet në qëllimin dhe kuptimin e këtij neni, me përmbajtje: *“Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohej sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.”*

30. Gjykata vlerëson se *ratio* i nenit 34 të Kushtetutës është sanksionimi i parimit “të mos gjykimit dhe dënimit dy herë për të njëjtën vepër penale” (*ne bis in idem*) dhe parimit të “gjësë së gjykuar” (*res judicata*). Këto dy parime vijnë si garanci të konfirmuara nga kjo dispozitë kushtetuese, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të individit në fushën penale.

31. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se neni 34 i Kushtetutës parashikon se qëllimi i gjykimit dy herë ka edhe përjashtim, që nënkupton se kur plotësohen disa kushte, çështja mund të rigjykohej, por gjithmonë mbi bazën e ankimit. Shprehja “rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë” në nenin 34 të Kushtetutës tregon se rigjykimi, si përjashtim i ndalimit të gjykimit dy herë, nuk mund të vendoset me nismë të gjykatës, por merr shkak në çdo rast nga ankimi. Në këtë kontekst, kjo shprehje duhet parë e lidhur me përmbajtjen e nenit 43 të Kushtetutës, që garanton të drejtën e ankimit ndaj çdo vendimi gjyqësor, dispozitë e cila në përmbajtjen e saj përdor sërish konceptin “gjykatë më e lartë”.

32. Në vlerësimin e Gjykatës, shprehja *“rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj”*, parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës, nuk i referohet posaçërisht vetëm kërkesës për rishikim si fazë procedurale e institutit të rishikimit, sikundër e lexon kërkesja gramatiksht, për rrjedhojë as përcaktimit të gjykatës kompetente për shqyrtimin e pranimin të kërkesës për rishikim, por i referohet institutit të rishikimit si tërësi me të dyja fazat dhe të gjitha garancitë e procedurat që ky

institut ofron sipas ligjit, veçanërisht garantimin e së drejtës së ankimit për të dënuarin.

33. Gjithashtu, Gjykata thekson se me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, Kushtetuta ka pësuar ndryshime edhe në përcaktimin e kompetencës së Gjykatës së Lartë. Neni 141, pika 1, i Kushtetutës, thotë: “Gjykata e Lartë shqyrtton çështje lidhur vetëm me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit”. Duke mbajtur në konsideratë këtë fakt, Gjykata thekson se parashikimet ligjore për kërkesën për rishikim, sipas nenit 453 të KPP-së, kanë ardhur edhe si pasojë e ndryshimit të kompetencës ligjore të Gjykatës së Lartë, duke e parashikuar si gjykatë me qëllime unifikuese të interpretimit të ligjit dhe të harmonizimit të praktikës gjyqësore.

34. Gjykata evidenton se edhe në nenin 4 të Protokollit shtesë nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “E drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë”, parashikohet se: *“Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë shpallur i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti. Dispozitat e paragrafit të mësipërm nuk pengojnë rihapjen e procesit, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të Shtetit të interesuar, në rast se fakte të reja ose të zbuluara rishtazi, ose një mangësi themelore në procedimet e mëparshme janë të një natyre të tillë, që mund të cenojnë vendimin e dhënë. Asnjë derogim nuk lejohet për këtë nen në përputhje me nenin 15 të Konventës.”*

35. Po në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se autoriteti që ushtron kompetencën e rishikimit të një akti ose procesi duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjetur një balancë të drejtë midis interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë (*çështja Bujnita kundër Moldavisë, 16 janar 2007 dhe çështja Xheraj kundër Shqipërisë, 29 korrik 2008*).

36. Çështja e rihapjes së proceseve gjyqësore si një formë e *restitutio in integrum* është objekti edhe i Rekomandimit R (2000) 2 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për rishqyrtimin ose rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel të brendshëm. Gjykata vëren se qëllimi



themelor i rekomandimit është të sigurojë një mbrojtje të përshtatshme të viktimave ndaj disa shkeljeve të rënda të Konventës, të konstatuara nga GJEDNJ-ja. Ky sistem nënkupton që individët në fjalë duhet të kenë të drejtë të paraqesin kërkesat e nevojshme para gjykatave kompetente ose para një organi tjetër të brendshëm (*shih rekomandimin R(2000)2 të Këshillit të Evropës*).

37. Nga sa më lart, Gjykata thekson se referuar edhe standardeve ndërkombëtare nuk ka detyrime të cilat referojnë patjetër te një gjykatë më e lartë në shkallë, për sa i përket vendimit që urdhëron rigjykimin e çështjes, por e lënë në vlerësimin e shteteve, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të shtetit përkatës.

38. Edhe në drejtim të së drejtës së ankimit, Gjykata vëren se sipas modelit të përzgjedhur nga ligjvënësi, me ndryshimet që iu bënë KPP-së në vitin 2002, ky lloj vendimi konsiderohej i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të paraqitej ankimi, për sa kohë që kompetencën për të shqyrtuar kërkesën për rishikim e kishte gjykata më e lartë brenda sistemit gjyqësor. Ndërkohë, vetë Gjykata e Lartë ka shqyrtuar, sipas kompetencës së kohës, rishikimin e vendimeve të dhëna prej saj. Duke iu referuar rregullimit të ri kushtetues që i është bërë Gjykatës së Lartë me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, në drejtim të kompetencave të saj, ajo shqyrton vetëm çështje që lidhen me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Edhe në nenin 432 të KPP-së janë përcaktuar në mënyrë të qartë shkaqet për të cilat mund të investohet Gjykata e Lartë për ushtrimin e kompetencës së saj si gjykatë ligji. Në këtë kuptim, zgjedhja e modelit të shqyrtimit të kërkesës për rishikim do të ishte ose gjykata e shkallës së parë, ose gjykata e apelit. Nëse kompetenca do t'i lihej gjykatës së apelit, si gjykatë më e lartë fakti, përsëri do të kishte të njëjtat pasoja për individin në drejtim të paankueshmërisë së vendimit në një gjykatë më të lartë se ajo që shqyrton kërkesën, ose në drejtim të rishikimit të vendimeve të dhëna prej saj.

39. Në vazhdimësi të kësaj analize, Gjykata vlerëson se dhënia e kompetencës për kërkesat për rishikim, si mjet i jashtëzakonshëm ankimi, gjykatës së shkallës së parë, është një garanci më

e lartë për interesat e të dënuarit se sa do të ishte në kushtet e caktimit i kësaj kompetence gjykatave më të larta (p.sh. Gjykatës së Lartë, vendimi i së cilës nuk do të kishte ankimi), pasi sistemi i apelit dhe rekursit, i cili parashikon të drejtën e ankimit, në të dyja fazat e procesit të rishikimit në tërësi, sipas parashikimeve të neneve 449–458 të KPP-së, e garanton kontrollin e shkallëzuar gjyqësor, në kuptimin vazhdues të procesit, sikundër edhe neni 34 i Kushtetutës përcakton.

40. Duke iu referuar edhe kontekstit historik, Gjykata vëren se shqyrtimi i kërkesës për rishikim nga gjykata e shkallës së parë ka qenë pjesë e legjislacionit procedural penal, në formën fillestare të KPP-së, miratuar në vitin 1995. Konkretisht, referuar neneve 452–456 të KPP-së, kërkesa për rishikim, ashtu si edhe gjykimi i rishikimit, bëheshin pranë gjykatës së shkallës së parë. Në lidhje me të drejtën e ankimit, KPP-ja parashikonte se vendimi i dhënë në gjykimin e rishikimit mund të ankimohej në gjykatën e apelit (neni 458). Ky parashikim ligjor është zbatuar gjatë viteve 1995–2002. Nga kjo pikëpamje, procedura e rishikimit e urdhëruar nga një gjykatë e të njëjtit nivel i është përgjigjur në kohë konceptit kushtetues të “gjykatës më të lartë”, edhe në kohën e miratimit të KPP-së, kur vepronte neni 9 i ligjit nr. 7561/1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, sipas të cilit “vendimet gjyqësore mund të anulohen, të prishen ose të ndryshohen vetëm me vendim të një gjykate më të lartë, në kushtet e parashikuara me ligj”. Gjithashtu, procedura e rishikimit, e urdhëruar nga një gjykatë e të njëjtit nivel, i është përgjigjur konceptit kushtetues të “gjykatës më të lartë” edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, që solli konceptin kushtetues të “gjykatës më të lartë” në nenet 34 dhe 43, deri në vitin 2002 me ndryshimet e ligjit nr.8813, datë 13.6.2002 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”.

41. Për sa më lart, në përfundim të kësaj analize, Gjykata vlerëson se standardet e përmendura në nenin 34 të Kushtetutës nuk cenohen nga parashikimet ligjore të KPP-së për institutin e rishikimit, në kuadrin e tërësisë së



këtij instituti, duke përfshirë vendimmarrjet e gjykatave si në fazën e kërkesës për rishikim, edhe në fazën e gjykimit të rishikimit, por edhe apelimet, si dhe rekursat ndaj këtyre vendimeve, si garancia më e lartë e të dënuarit kur ushtron të drejtën e rishikimit ndaj një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

42. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e gjykatës referuese se pikat 1 dhe 3 të KPP-së, sipas objektit të kërkesës, bien në kundërshtim me nenet 4, 34 dhe 116 të Kushtetutës, janë të pabazuara dhe nuk duhen pranuar.

B.2. Për pretendimin e cenimit të parimit të pavarësisë në aspektin e kontrollit gjyqësor të shkallëzuar

43. Kërkesja pretendon se neni 453 i KPP-së, pikat 1 dhe 3, sipas objektit të kërkesës, bien ndesh me parimin e pavarësisë në aspektin e kontrollit gjyqësor të shkallëzuar, sanksionuar në nenet 135 dhe 145 të Kushtetutës. Sipas saj, kontrolli i shkaqeve të kërkesës për rishikim dhe më pas dërgimi i çështjes për gjykim të rishikimit në shkallën e parë, me trup tjetër gjykses, cenon këto parime kushtetuese.

44. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, prapëson se ndryshimi i nenit 453 të KPP-së ka ndryshuar vetëm gjykatën e rishikimit. Lejimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës rishikuese garanton parimin se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar, sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga ato më të larta. Në hartimin e ligjit nr. 35/2017, ligjvënësi i ka pasur në konsideratë përcaktimet kushtetuese dhe zgjidhja e bërë prej tij, në lidhje me gjykatën që shqyrton rishikimin, nuk cenon asnjë nga parimet kushtetuese të pretenduara në kërkesën e gjykatës referuese. Gjithashtu, edhe subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, prapëson se nuk cenohet asnjë parim kushtetues.

45. Gjykata çmon t'i vlerësojë këto pretendime në këndvështrimin e standardeve kushtetuese të lidhura me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut dhe garancitë për ankimin dhe kontrollin gjyqësor që Kushtetuta parashikon për çdo individ, për rrjedhojë edhe për të dënuarit që kërkojnë të përfitojnë nga instituti i rishikimit të vendimeve të formës së prerë.

46. Kushtetuta në nenin 135 parashikon se pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë,

si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Ndërsa, neni 145, pika 1, i Kushtetutës parashikon: “Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”. Këto parime kushtetuese janë analizuar gjerësisht nga Gjykata, e cila rithekson disa nga standardet e saj, sipas të cilave, pavarësia e gjyqtarëve dhe e gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, t’u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimin nr. 5, datë 16.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Në këtë kuptim, pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme, ka edhe një pavarësi të brendshme, në kuptimin që gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*shih vendimin nr. 40, datë 7.7.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në drejtim të pavarësisë së brendshme të pushtetit gjyqësor, Gjykata rithekson se është po aq e rëndësishme sa edhe pavarësia e jashtme e tij. Një gjyqtar, në ushtrimin e funksioneve të tij, është vartës i askujt; ai ose ajo është bartës i një funksioni shtetëror dhe, në këtë kuptim, i shërben dhe i përgjigjet vetëm ligjit. Pavarësia e gjyqësorit nuk është vetëm e pushtetit si një i tërë *vis-à-vis* pushteteve të tjera të shtetit, sepse ka edhe një aspekt të “brendshëm”. Çdo gjyqtar, pavarësisht vendit të tij në sistemin gjyqësor, ushtron të njëjtin autoritet gjykimor (*shih vendimin nr. 34, datë 10.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave, si dhe autoriteti i tyre gjyqësor, nuk janë një qëllim në vetvete. Respektimi i këtij parimi është një kusht i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në paragrafin e dytë të nenit 42 të Kushtetutës parashikohet: “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”. Në këtë kuptim, kjo pavarësi nuk është një privilegj, por një nga detyrat themelore të gjyqtarëve dhe të gjykatës, që rrjedh nga të drejtat e njeriut për të pasur një arbitër të



paanshëm në një konflikt, të garantuar nga Kushtetuta. Garantimi i një standardi të tillë përbën dhe kriterin orientues për të vlerësuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Në këndvështrim të këtyre standardeve, Gjykata vlerëson se parimi i pavarësisë dhe i shkallëzimit të kontrollit gjyqësor, si dhe organizimi kushtetues i këtij pushteti, te pjesa e nëntë e Kushtetutës (Gjykatat), nenet 135–147/ë të saj, janë përcaktime dhe parime kushtetuese në funksion të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Në këtë këndvështrim, për sa kohë që, sipas analizës së Gjykatës, instituti i rishikimit si tërësi garanton të drejtën e ankimit të të dënuarit, përmes apelimit dhe rekursit, në të dyja fazat e procesit, atë të refuzimit të kërkesës për rishikim dhe kur kërkesa për rishikim pranohet, të vendimit gjyqësor të rishikuar, parashikuar nga nenet 449 - 458 të KPP-së (*paragrafët 32 e 39 të vendimit*), atëherë edhe standardi i garancive kushtetuese të ankimit dhe të kontrollit gjyqësor të shkallëzuar është i garantuar.

50. Gjykata thekson se sistemi gjyqësor është një sistem korrigjues subsidiar, i cili nga mënyra se si është ndërtuar dhe funksionon u përgjigjet të gjitha pretendimeve për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, dhe individi ka mundësinë që në çdo hallkë, fazë ose shkallë të procesit të ngrejë pretendime konkrete për gjykatën e pavarur dhe të paanshme, të krijuar me ligj. Gjithashtu, sipas Gjykatës, parimi i shkallëzimit duhet të interpretohet duke u dhënë kuptim të gjitha normave kushtetuese, në kuptimin që nëse interpretohet vetëm literalisht, ai nuk u jep zgjidhje të gjitha situatave.

51. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e gjykatës referuese nuk janë argumentuar nga pikëpamja e standardeve kushtetuese, prandaj dhe nuk janë të bazuara në kuptim të cenimit të parimit të shkallëzimit të pushtetit gjyqësor.

52. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e gjykatës referuese, se togfjalëshi “nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit”, parashikuar në pikën 1 të nenit 453 të KPP-së, si dhe togfjalëshi “..i së njëjtës gjykatë”, i parashikuar në pikën 3 të nenit 453 të

KPP-së, bien ndesh me Kushtetutën, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.1.2021

Shpallur më 26.2.2021

KRYETARE: Vitore Tusha

ANËTARË: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo, Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim lidhur me legjitimitimin pjesërisht të gjykatës referuese, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi për sa vijon.

2. Siç rezulton nga vendimi, shumica është shprehur lidhur me legjitimitimin e gjykatës referuese: “Gjykata vëren se në të gjitha kërkesat gjykata referuese është vënë në lëvizje nga kërkesa për rishikim e të pandehurve kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë që kanë vendosur fajësinë e tyre. Bazuar në pikën 3 të nenit 453 të KPP-së, kompetenca e gjykatës referuese, nëse arrin në përfundimin se kërkesa për rishikim do të pranohet, është të vendosë dërgimin e çështjes për rigjykim një tjetër trupi gjykues të së njëjtës shkallë (Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në rastet në shqyrtim). Për pasojë, Gjykata vlerëson se bazuar në nenin 48, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, gjykata referuese nuk legjitimohet në lidhje me pretendimet e



lidhura me dërgimin e çështjes për rigjykim nga gjykata e shkallës së parë në gjykatën e apelit, pasi nuk gjendet në asnjë nga rastet që ka për shqyrtim përpara saj. Në përfundim, Gjykata çmon se gjykata referuese plotëson kriteret e legjitimitetit, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr. 8577/2000, vetëm në rastet e dërgimit të çështjes për rigjykim nga një trup gjykues në një tjetër të së njëjtës shkallë” (*paragrafi 22 i vendimit*).

3. Sikundër konstatohet, në thelb shumica e ka kufizuar shqyrtimin e çështjes, duke mos marrë në analizë pretendimet e gjykatës referuese të lidhura me dërgimin e çështjes për rigjykim nga gjykata e shkallës së parë në gjykatën e apelit, kur kërkesa është bërë vetëm kundër vendimit të saj, sipas nenit 453, pika 3, të KPP-së, me argumentin se gjykata referuese nuk gjendet në asnjë rast përpara kësaj situatë.

4. Gjykata referuese ka parashtruar në kërkesën e saj se neni 453, pikat 1 dhe 3 të KPP-së, sipas objektit të kërkesës, bie ndesh me parimin se pushteti gjyqësor ushtrohet i shkallëzuar, sipas parimit të kontrollit të gjykatave më të ulëta nga ato më të larta, parashikuar nga neni 135 i Kushtetutës, pasi nuk ka kuptim që një trup gjyqësor i së njëjtës shkallë të prishë dhe të rikthejë për rigjykim një vendim gjyqësor të gjykuar nga një trup gjykues i së njëjtës shkallë gjykimi, ose të një gjykate më të lartë, sikurse është ajo e apelit (*shih paragrafin 15 të kërkesës, me numër akti 687, datë 6.9.2018*).

5. Nga sa më lart, gjykata referuese, bazuar në nenin 68/2 të ligjit nr.8577/2000, ka parashtruar si shkak antikushtetutshmërie edhe situatën kur gjykata e shkallës së parë ia dërgon çështjen për rigjykim gjykatës së apelit.

6. Në vlerësimin tonë kjo Gjykatë kishte detyrimin e përcaktimit të kufijve të shqyrtimit të çështjes brenda objektit të kërkesës dhe për të gjitha shkaqet e parashtruara në të, si dy kushte ligjore të plotësuara njëkohësisht, pa e kufizuar legjitimitetin e gjykatës referuese vetëm për një pjesë të shkaqeve të parashtruara në kërkesë. Shqyrtimi dhe analiza e çështjes nga pikëpamja e standardeve kushtetuese është e ndërvarur dhe e ndërlidhur edhe me pretendimet për antikushtetutshmëri në rastin kur çështja dërgohet për rigjykim nga gjykata e shkallës së

parë në gjykatën e apelit, kur kërkesa për rishikim është bërë vetëm kundër vendimit të saj.

7. Neni 48 i ligjit nr .8577/2000 parashikon se kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të. Në parashtrimet e saj gjykata referuese ka paraqitur si shkak antikushtetutshmërie pretendimin se togfjalëshi “nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin në dhomën e këshillimit” (pika 1 e nenit 453 të KPP-së) bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë nuk mund të jetë gjykatë kompetente as për dërgimin e çështjes në të njëjtën gjykatë me trup tjetër gjykues, as për dërgimin e çështjes në gjykatën e apelit, kur kërkohet vetëm rishikimi i këtij vendimi. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se shtrirja e kufijve të shqyrtimit të çështjes duhet të ishte realizuar edhe brenda kësaj pjese të objektit të kërkesës. Për më tepër, referuar pikës 2 të nenit 48 të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata mund ta shtrijë shqyrtimin edhe në akte të tjera normative, kur ajo vlerëson se ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe këtyre akteve. Mendojmë se çështja objekt shqyrtimi është pikërisht rasti kur kjo Gjykatë do të duhej të shprehej edhe në lidhje me këtë pretendim të kërkuar, bazuar edhe në pikën 2 të nenit 48 të ligjit nr. 8577/2000.

8. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. (*shih vendimet nr.2, datë 18.1.2017; nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 5, datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, kjo qasje e shumicës, nga pikëpamja konkrete dhe praktike, për të ardhmen, i vë gjykatat e shkallës së parë në situatën ku për zgjidhjen e çështjeve, në hipotezën që do të kenë për shqyrtim një kërkesë për rishikim ku i kërkohet dërgimi në gjykatën e apelit, do të duhej ose ta pezullonin gjykimin dhe



ta dërgonin çështjen pranë Gjykatës Kushtetuese, ose duke ndjekur linjën e arsytimit të kësaj gjykate për çështjen në shqyrtim do të duhej të bënin të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën, nisur nga fakti se arsytimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrues dhe ka forcën e ligjit. Në këtë linjë ne vlerësojmë se shumica, për të shmangur edhe efekte të paqarta nga pikëpamja praktike, do të duhej të arrinte në konkluzione përfundimtare për pikat 1 dhe 3 të nenit 453 të KPP-së.

9. Nga ana tjetër referuar qëndrimit të shumicës, arrihet në konkluzionin se kur gjykatës së shkallës së parë do t'i paraqitet kërkesa për rishikim për një vendim të gjykatës së apelit, do të duhet ta pezullojë gjykimin dhe ta dërgojë çështjen para Gjykatës Kushtetuese. Kjo lloj qasje vetëm sa e shtyn në kohë shqyrtimin e kësaj pjese të kërkit, por nuk i mbyll dilemat për antikushtetutshmëri për një pjesë të dispozitës, referuar paragrafit 3 të nenit 453 të KPP-së, shprehjes “ose ia dërgon gjykatës së apelit”, sikundër u shprehëm më lart (paragrafi 8 i kësaj pakice).

10. Ndërkohë, linja e arsytimit e mbajtur nga kjo Gjykatë dhe tërësia e argumenteve të shtjelluara për interpretimin e nenit 34 të Kushtetutës, duket se u jep përgjigje edhe shkaqeve për antikushtetutshmëri, në rastet kur kërkesa për rishikim pranohet nga gjykata e shkallës së parë dhe i dërgohet gjykatës së apelit, dhe në këtë kuptim përforcon edhe më shumë argumentin se gjykata referuese nuk duhej të kufizohej në legjitimitimin e pjesshëm.

11. Si konkluzion, për të gjitha arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë nuk duhej të legjitimonte pjesërisht gjykatën referuese.

Shpallur më 26.2.2021.

ANËTARË: Përparim Kalo, Elsa Toska

VENDIM Nr. 3, datë 26.2.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha, kryetare e Gjykatës Kushtetuese			
Elsa Toska,	anëtare e	“	“
Marsida Xhaferllari,	anëtare e	“	“
Altin Binaj,	anëtar i	“	“
Përparim Kalo,	anëtar i	“	“
Sonila Bejtja,	anëtare e	“	“
Fiona Papajorgji,	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, më datë 11.2.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 3 akti, që u përket:

KËRKUES: DURIM SULKJA

SUBJEKTE TË INTERESUARA: PETRO SINANI, ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “F”, 132, pika 1 dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 31, 71, 71/a, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, të cilat nuk kanë ngritur pretendime në lidhje me objektin e kësaj kërkesë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është banor i qytetit të Elbasanit dhe ka pasur në pronësi një apartament me përbërje 1+1 po në këtë qytet. Me vendim të Bashkisë Elbasan, datë 24.6.1993, kërkuesit i është dhënë një apartament 2+1 që dorëzonte personi i tretë, shtetasi P.S. ndërsa ky i fundit ka marrë apartamentin e dorëzuar nga kërkuesi. Kërkuesi rezulton të jetë futur në këtë apartament në vitin 1996, sapo personi i tretë e ka liruuar atë.

2. Në datën 12.2.1999, Enti Kombëtar i Banesave (EKB) ka bërë vlerësimin e apartamenteve të dorëzuara, dhe sipas procesverbalit përkatës apartamenti 1+1, i dorëzuar nga kërkuesi, është vlerësuar 428.773 (katërqind e njëzetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, ndërsa apartamenti 2+1, i dorëzuar nga personi i tretë P.S. dhe i marrë nga kërkuesi, është vlerësuar 928.305 (nëntëqind e njëzetë e tetë mijë e treqind e pesë) lekë. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë me objekt: “Anulimi i vlerës dhe detyrimi i palës së paditur për të lidhur kontratën e apartamentit”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1712 (13-2209-5001), datë 3.7.2009, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesëpadi. Anulimin e vlerës së dalë nga vlerësimi i apartamentit 500/3 (500/5) të bërë nga pala e paditur EKB në datën 17.6.1999, ndaj personit Durim Sulkja për shumën 1.021.120 lekë, detyrimin e palës së paditur EKB të lidhë kontratën me paditësin Durim Sulkja sipas vlerës së përcaktuar nga ekspertja në këtë gjykim, në shumën 10.889 lekë.”*

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2012-1538 (762), datë 23.10.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1712 (13-2209-5001), datë 3.7.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 00-2017 (853), datë 21.11.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 10-2012-1538 (762), datë 23.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës.

6. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese në datën 20.6.2018 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

7. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (ligji nr. 49/2012), ka parashikuar afatin 90-ditor brenda të cilit duhen shqyrtuar çështjet nga Gjykata e Lartë, ndërkohë që çështja e tij është shqyrtuar rreth 4 vjet pas regjistrimit të saj.

8. *Subjekti i interesuar*, Petro Sinani, në parashtrimet e tij drejtuar Gjykatës, ka paraqitur prapësime në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes, ndërkohë që në lidhje me pretendimin e kërkuesit për mosshqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, nuk ngre pretendime, por e lë në çmim të Gjykatës.

9. *Subjekti i interesuar*, EKB-ja, në parashtrimet e paraqitura pranë Gjykatës, nuk ka paraqitur pretendime për çështjen objekt të kësaj kërke, por i referohet procesit të mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 10-2012-1538 (762), datë 23.10.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës. Sipas këtij subjekti, Dega Rajonale Elbasan e EKB-së është shprehur e gatshme për ekzekutimin e vendimit për t’u paraqitur për lidhjen e kontratës. Për pasojë, mosekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë ka ardhur si rrjedhojë e mosveprimeve të kërkuesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

10. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje në seancë plenare.

*A. Për legjitimimin e kërkuarit*

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

12. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraparak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej kriterëve që kërkuar të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

13. Për çështjen në shqyrtim, kërkuar pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjyimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

14. gjykata vlerëson se kërkuar legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin ka ngritur pretendime në gjykatën kushtetuese dhe, si i tillë, ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike*, gjykata thekson se ai është një ndër kushtet paraprake që duhet plotësuar për legjitimimin e kërkuarit, që buron nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i kushtetutës. ky i fundit parashikon se gjykata kushtetuese kryen gjykimin përfundimtar të ankesave individuale, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individit pretendon se i janë cenuar nga vendimi gjyqësor. përmbushja e këtij kushti

është konkretizuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga gjykata kushtetuese kur kërkuar i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet asaj ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

16. shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron gjykata kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 56, datë 25.7.2017 të gjykatës kushtetuese*). kushti për shterimin e mjeteve juridike nënkupton se kërkuar duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr.17, datë 16.5.2011 të gjykatës kushtetuese*).

17. përpara ndryshimeve ligjore që i janë bërë kodit të procedurës civile (kpc) në vitin 2017, gjykata ka vlerësuar se në bazë të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të kushtetutës individit legjitimohej për të pretenduar drejtpërdrejt në gjykatën kushtetuese cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor edhe për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të gjykatës kushtetuese*).

18. me ndryshimet që i janë bërë kpc-së me ligjin nr. 38/2017 (të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 5.11.2017), tashmë çdo personi i janë ofruar mjete të reja ligjore për t’u mbrojtur efektivisht nga cenimi i së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. konkretisht, kpc-ja përcakton se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (neni 399/2), me çfarë mjeteve mbrohesh nga cenimi: kërkesa për përsheptim (neni 399/4) dhe kërkesa për dëmshpërblim, dhe çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (neni 399/3), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës (nenet 399/4 dhe 399/6), rregullat për gjykimin e kërkesës (neni 399/7), marrja e vendimit (neni 399/8), etj. për rrjedhojë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore efektive nëpërmjet të cilave individëve u garantohet mbrojtja efektive në lidhje me pretendimet për cenimin e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe për



ekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

19. Në lidhje me zbatimin në kohë të ligjit nr. 38/2017, Gjykata çmon se ligjvënësi duke përcaktuar në dispozitat kalimtare të ligjit (neni 109, pika 3) regjimin kalimtar në lidhje me shtyrjen e afateve kohore që konsiderohen të arsyeshme për çështjet që janë në proces në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KPC-së, nënkupton se ligji do të gjejë zbatim edhe për çështjet që janë ose do të jenë në shqyrtim pas datës 5 nëntor.

20. Nga ana tjetër, parimi i zbatimit në kohë të ligjit, ndonëse nuk përcaktohet shprehimisht si rregull i veçantë në Kushtetutë, me përjashtim të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues (neni 29, pika 3) dhe ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit për taksat, tatimet dhe detyrimet financiare (neni 155), lidhet me shtetin e së drejtës dhe procesin e rregullt ligjor, në kuptimin që siguria juridike kërkon që kushdo të jetë në gjendje të parashikojë se si zbatohet ligji në një situatë të caktuar. Për sa i takon zbatimin në kohë të ligjit procedural, Gjykata thekson se përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe, ai zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum*. Jurisprudenca kushtetuese është shprehur edhe më parë se në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (shih vendimet nr. 106, datë 27.5.2002; nr. 11, datë 23.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj për zbatimin e ligjit nr. 38/2017 ka theksuar: “Gjykata vlerëson të theksojë paraprakisht se nga data 5 nëntor 2017 ka hyrë në fuqi ligji nr. 38/2017 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, ligj i cili ka shtuar kreun X “Mbi gjykimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit”. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimin e çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve. Sipas ndryshimeve të fundit ligjore do të ketë një mjet ligjor ankimi, i prezumuar efektin, që do të garantojë si përsheptim të procesit gjyqësor penal, civil ose administrativ, ashtu edhe dëmshpërblim, pra një rezultat konkret në drejtëm të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore. Kodi i

Procedurës Civile nuk ka parashikuar efekte prapavepruese për çështjet të cilat kanë përfunduar në themel pranë gjykatave të zakonshme dhe për të cilat kanë kaluar afatet e arsyeshme sipas parashikimeve ligjore përkatëse, por ka rregulluar edhe specifikuar rregulla dhe procedura për çështjet që janë ose do të jenë në shqyrtim pas datës 5 nëntor pranë gjykatave të zakonshme në lidhje me pretendimet për kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit gjyqësor” (shih vendimin nr. 76, datë 4.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Në rastin konkret Gjykata konstaton se sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë në datën 6.11.2017 është shpallur data 21.11.2017 për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ndryshimet e sipërcituara të KPC-së gjejnë zbatim edhe për këtë çështje. Konkretisht, në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 399/6 të KPC-së parashikohet se kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile ose administrative dhe në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje është duke u gjykuar në Gjykatën e Lartë, kërkesa shqyrtohet nga një kolegji tjetër i kësaj gjykate.

23. Gjithashtu, Gjykata vlerëson të theksojë se edhe pse ligji nr. 38/2017 ka hyrë në fuqi në datën 5 nëntor të vitit 2017, ai është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 98 të datës 5 maj 2017, pra rreth 6 muaj përpara dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë për çështjen e kërkesës. Në këto raste një nga qëllimet e ligjvënësit për publikimin e ndryshimeve ligjore dhe lënien e një afati të caktuar për hyrjen në fuqi të tyre, është që qytetarët dhe profesionistët e së drejtës të njihen me këto ndryshime.

24. Si përfundim, Gjykata çmon se kompetenca për shqyrtimin e kërkesave për cenimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të çështjeve i përket gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe se kërkesuesi i ka pasur mundësitë që pretendimin e tij për cenim të këtij afati ta paraqiste përpara Gjykatës së Lartë pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja ligjore,

25. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate për të kërkuar cenimin e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 11.2.2021

Shpallur më 26.2.2021

KRYETARE: Vitore Tusha

ANËTARË: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska,
Përparim Kalo, Altin Binaj, Fiona Papajorgji,
Sonila Bejtja

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë